



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008), nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011 dhe nenit 5.1 të Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Vitisë nr 01-013/246 të datës 02.03.2015, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENT

I

FORMOHET Komisioni për ndarjen e bursave për student të Komunës së Vitisë për vitin akademik 2016/2017 sipas konkursit të publikuar nga Drejtoria komunale për Arsim e Komunës së Vitisë.

Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve dhe ka këtë përbërje:

1. Berat Zuka – Kryetar i komisionit,
2. Arian Alidema – anëtar i komisionit,
3. Shqipe Rexhepi – anëtare e komisionit,
4. Ibadete Hyseni – anëtare e komisionit dhe
5. Fatlum Demiri - anëtar i komisionit.

II.

Komisioni nga neni 1 i këtij vendimi ka për detyrë që ti shqyrtoj të gjitha aplikacionet të cilat janë paraqitë pranë Drejtorisë për Arsim për ndarjen e bursave për student për vitin akademik 2016/2017 dhe gjatë ndarjes së bursave të respektoj të gjitha kushtet dhe kriteret për ndarjen e bursave të publikuara në konkurs dhe Rregulloren për ndarjen e bursave për student të Komunës së Vitisë nr 01-013/246 të datës 02.03.2015.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryetari i Komisionit.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të komisionit
2. Drejtorisë për Arsim
3. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti

